

ZANA E MALEVE

Giovani e Territorio: radici di una comunità in cammino verso l'integrazione con la famiglia europea
AID 011523/VIS/ALB

Hapat e implementimit të programit për Bursen e Punës

Bursa e Punës është një program i menduar për nxitjen e të rinjve për të punuar. Të rinjtë e zonës Malësi e Madhe dhe jo vetëm, paraqesin shumë vështirësi për tu integruar në tregun e punës, kjo për shumë arsye që janë sociale ashtu edhe ekonomike por edhe mentaliteti dhe dëshira për të emigruar kanë bërë që deëhira dhe angaxhimi për punë i të rinjve të jetë shumë i vogël.

Për të ndikuar në ndryshimin e kësaj situatë duhet të përdoren disa mekanizma lehtësues që afrojnë mundësinë dhe nxisin dëshirën e të rinjve me ofertën që aktualisht paraqet tregu i punës (bisnesi) në Malësinë e Madhe.

Për implementimin e programit të Bursave të punës, kemi planifikuar që procesi duhet të kalojë në disa etapa.

1. Njohja me programin

Në këtë fazë fillestare të këtij programi, vetë stafi që do të angazhohet në këtë program do të njihet me të, me mundësitë dhe detyrat e mirëpërcaktuara. Gjatë prezantimit të këtij programi do të përcaktohet qartë qellimi për të cilin po realizohet, angazhimi i stafit kush dhe çfarë do të bëjnë si dhe pritshmeritë e këtij programi që do të kenë edhe impaktin në territor.

2. Studimi i tregut të punës

Studimi i tregut të punës është një etapë shumë e rëndësishme për programin.

Hartëzimi i këtij tregu me mundësitë që ofron, kërkesat që paraqet, hapësirat që krijon na jep një panoramë të qartë mbi situatën aktuale të tregut të punës në të gjithë Malësinë e Madhe.

Për këtë fazë është e rëndësishme krijimi i pyetësorit sa më të qartë dhe të plotë në kërkesa, si dhe plotësimi me korrektësi i tij në të gjithë bizneset që ushtrojnë aktivitetin në Malësi të Madhe.

Për këtë përfaqësueset e CODE Partners do të krijojnë pyetësorin i cili do të plotësohet në çdo biznes të licensuar që ushtron veprimtarinë në territorin e Malësisë së Madhe (shih formularin bashkëngjitur)

3. Krijimi i një database me të dhënat e biznesit

Kjo faze e projektit bëhet pasi të jenë plotësuar të gjithë formularët, ky proces paraqet rëndësi pasi do na japë një panoramë përmbledhëse të qartë për të gjithë situatën e tregut të punës. Me krijimin e mirë të këtij database, ne do të nxjerrim menjëherë jo vetëm kërkesat që tregu i punës sot ofron në Malësi të Madhe, por edhe specifikisht çfarë kërkesë ky treg ka, sa

In collaborazione con:

ZANA E MALEVE

Giovani e Territorio: radici di una comunità in cammino verso l'integrazione con la famiglia europea

AID 011523/VIS/ALB

mundësi ofron biznesi jo vetëm në numër kërkesash për vende pune por edhe me specifikat për pozicionin, periudhen, gjininë etj. sepse kërkesat janë të ndryshme në këto biznese.

Për këtë proces një punonjëse e VIS do të pasqyrojë të gjithë të dhënat që kanë dalë nga puna në këtë fazë. (shih database të dhënash)

4. Profilizimi i përfituesve të programit,

Kjo etapë e zhvillimit të programit është shumë e rëndësishme .

Percaktimi i kriterëve përzgjedhëse për të rinjtë janë doemosdoshmërisht **mosha 18-30** vjeç dhe do të jenë **banorë të Malësisë së Madhe**, por në qoftë se kërkesa e të rinjve është më e madhe se oferta duhet të përcaktohen edhe kriterë të tjera përzgjedhëse në varësi edhe të përshtatshmërisë me ofertën.

Si psh:

- **të rinjë kryefamiljarë**
- **gjendja social-ekonomike e vështirë**
- **të rinj me një prind**
- **familje me shumë anëtarë etj.**

Ky përcaktim kriteresh do të ketë një transparencë të madhe dhe gjithashtu përveç impaktit integruar të të rinjve do të ketë edhe një impakt social.

Përzgjedhja do të bëhet nga grupi i punës me metodë pikëzimi duke përshtatur kërkesën me ofertën.

5. Studimi mbi situatën e të rinjve, vlerësimi i të rinjve në të gjithë territorin e Malësisë së Madhe që kanë dëshirë të përfshihen në punë.

Ky hap i implementimit të programit është mjaft i rëndësishëm pasi për vetë shtrirjen gjeografike paraqet vështirësi për evidentimin e të rinjve që kanë dëshirë të punojnë.

Një tjetër problem i zonës dhe jo vetëm mendojmë se është edhe mungesa e dëshirës të të rinjve për punë dhe në këtë aspekt duhet të gjendet një mekanizëm i përshtatshëm për të nxitur të rinjtë për të punuar si mënyra më e mirë për një jetë më të mirë dhe dinjitoze.

6. Krijimi i një pyetësi për të rinjtë, në të cilin të kërkohen të dhëna të sakta për aftësinë, mundësinë dhe dëshirën që të rinjtë kanë për të punuar krahas këtyre kërkesave duhen edhe të dhëna personale por që do të kenë konfidencialitetin e duhur. Krijimi i këtij pyetësi do të përgatitet nga stafi i CODE Partners (formulari bashkëngjitur)

In collaborazione con:

ZANA E MALEVE

Giovani e Territorio: radici di una comunità in cammino verso l'integrazione con la famiglia europea
AID 011523/VIS/ALB

7. Krijimi i një database me të dhënat e të rinjve ku të pasqyrohen qartë jo vetëm të dhënat specifike por çdo mundësi dhe dëshirë që të rinjtë kanë shprehur.

Edhe kjo fazë është mjaft e rëndësishme sepse na jep një pasqyrim të saktë të kërkesave të të rinjve dhe na jep me pas mundësinë për të lidhur këtë kërkesë me ofertën e tregut të punës.

8. Trajnim me stafin mbi rolin dhe mënyrat e operimit në këtë program për të harmonizuar ofertën e tregut të punës me kërkesën dhe mundësinë e të rinjve.

Ky trajnim do të shërbejë për të rritur aftësinë e stafit në metodat e komunikimit dhe për të kuptuar impaktin social që duhet të ketë tek të rinjtë dhe tek i gjithë komuniteti ky proces i bursave të punës.

9. Takim me biznesin

Në këtë fazë do të bëhet takim me bizneset që kanë shprehur gadishmërinë për të bashkëpunuar me programin e bursave të punës.

Gjatë këtij takimi do të diskutohet për modalitetet, për njohjen e programmi, të drejtat dhe detyrimet e palëve, paraqitja dhe konsultimi i kontratës së bashkëpunimit (marrëveshje bashkëngjitur)

10. Takime individuale me të rinjtë, këshillim për punësim dhe nxitje për punësim.

Mendoj që takimet me të rinjtë që kanë shprehur dëshirën për punë të bëhen në mënyrë individuale, pasi sqarohen më saktë mundësitë dhe flitet më konkretisht për nxitjen e punësimit. Gjithashtu ky komunikim i jep më siguri dhe seriozitet procesit si dhe respekton konfidencialitetin.

11. Kontrata me të rinjtë ku në mënyrë të thjeshtë por të qartë shpjegohen të drejtat por edhe detyrimet që lindin me nënshkrimin e kësaj kontrate.

12. Mbikqyrja e procesit mes palëve punëdhënës – punëmarrës, është e shtrirë në të gjithë periudhën për të cilën është nënshkruar kontrata. Punonjësi i caktuar për mbikqyrjen e procesit duhet të njohë mirë edhe kontratën që VIS ka nënshkruar me biznesin, por edhe kontratën me të riun e punësuar.

Takimet që mbikqyrësi realizon duhet të jenë të vazhdueshme, të mirëpërcaktuara sipas një plani një mujor dhe të ndikojnë pozitivisht në mbarëvajtjen e punës dhe funksionimin e këtij procesi. Gjithashtu edhe raportimet për mbikqyrjen do të jenë mujore përveç rasteve emergjente që mund të paraqiten, ku, mbikqyrësi në qoftë se nuk arrin të zgjidhë problemin, i drejtohet me shkrim koordinаторit të programit për këtë situatë dhe në mënyrë të përbashkët arrijnë zgjidhjen.

In collaborazione con: